

10 VJETORI I APPK-së
7 maj 2010



Përmbajtja

▶ Parathënie	4
▶ Fjala përshëndetëse e z. Klaus Duenhaupt – Drejtor i AGEF Berlin	5 6
▶ Historiku i organizatës	7
▶ Struktura organizative, Bordi i drejtorëve dhe	4
▶ Bordi Këshillues i APPK-së	5
▶ Misioni, vizioni dhe vlerat e APPK-së	6
▶ Koncepti i biznesit dhe klientët	7
▶ Objektivat dhe aspiratat	4
▶ Partnerët vendor dhe ndërkombëtarë	5
▶ 13 Aktivitetet dhe shërbimet	6
▶ 17 Rastet e suksesshme	7
▶ 21 Projektet dhe aktivitetet aktuale	4
▶ 23 Të arriturat e APPK-së në shifra	5
▶ 37 Profilet e pjesëtarëve të stafit	6

10 vjet punë, mbi 10.000 individë të përkrahur në (ri)-integrimin ekonomik të tyre... Si u arrit kjo?



Të punosh në përkrahjen e (ri)-integrit të individit në shoqëri, te kesh përpara vetës individin që pret përkrahjen tënde, për APPK-në ishte dhe do jetë një punë tejet sfiduese, shumë e vështirë, por njëherit shumë e kënaq-shme, duke parë se me aktivitetet e implementuara individit po i kthehet dinjiteti i tij.

Krijimi i të ardhurave personale dhe stabiliteti ekonomik i individit, paraqesin për organizatën tonë vlera tejet të rëndësishme për prosperitetin e individit, familjes së tij por edhe shoqërinë në tërësi.

Ndërlidhja në mes të profesionale dhe njerëzores paraqesin faktorin kryesor të këtij suksesi.

I tërë sistemi i përkrahjes së individit nuk do të funksiononte pa përkrahjen e donatorëve.

BMZ (Ministria për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik e Gjermanisë),

AA (Ministria e punëve të jashtme të Gjermanisë),

SDC (Zyra për zhvillim dhe bashkëpunim e Zvicrës)

DRC (Enti për refugjatë i Danimarkës),
UNDP (programi për Zhvillim i kombeve të bashkuara),
ETF (European Training Fondation), ishin donatorët kryesorë që ia dhuruan projekteve tona "Gjeneratorin" për aktivizimin e sistemit të quajtur "Përkrahje e (ri)-integrit ekonomik të individit në shoqëri", si një faktor tejet të rëndësishëm të suksesit.

Koordinimi i shkëlqyeshëm me partnerët Institucional, por edhe përkrahja e tyre (MPMS, MTI, MASHT, MKK, Komuna e Prishtinës...), por edhe të shoqërisë civile, paraqesin faktorin tjetër të suksesit.

Themeluesi dhe ndërtuesi i kapaciteteve të APPK-së, Organizata AGEF nga Berlina, paraqet faktorin tjetër tejet të rëndësishëm në arritjen e suksesit përkrahës.

Të punësuarit e APPK-së, me profesionalizmin dhe qasjen njerëzore të tyre, krijuan kundrejt një pjese të qytetarëve Kosovarë sinonimin e përkrahësit të besueshëm, në rrugën e vështirë të (ri)-integrit ekonomik të tyre

Du faleminderit të gjithëve...

Vizioni - 20 vjetori me 20.000 tjerë të përkrahur!

Fjala përshëndetëse e z. Klaus Duenhaupt



Numri i emigrantëve në mbarë botën është shumëfishuar gjatë dekadave të fundit. Në vitin 2008 ishin bërë tashmë 200 milion tashmë 200 milion të tillë. Një e treta e migrirove bëhet në Evropë.

Migrimit që vjen si rezultat i krizave, luftërave, dëmeve mjedisore dhe persekutimeve politike i shtohet edhe migrimi me qëllim të shkollimit dhe punës.

Kthimi në vendin e origjinës pas disa viteve të kaluara jashtë, nuk është i pazakonshëm, por për çdo person apo familje të prekur nga ky fenomen paraqet një ndryshim serioz të mjedisit dhe kushteve të jetesës. Ristosistemi është një proces afatgjatë. Nëse ky proces është i suksesshëm ose jo, në mënyrë substanciale varet nga ekzistenca e burimit të të ardhurave, që siguron një jetë "normale".

Kosova për dekada me radhë ka qenë regjion ku migrimi luan rol në jetën e shumë njerëzve. Por situata në vitin 2000 ka qenë e veçantë për të kthyerit. Rregullat e mëparshme nuk vlenin më dhe çdo gjë duhej të riformohej.

Në vitin 2000, AGEF –i filloi programin "Punë për Kosovën", i cili financohej nga Ministria Federale e Gjermanisë për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik. Ky program fokusohet në promovimin e punësimit dhe ri-integritimit, me qëllim që përkundër kushteve të vështira ekonomike, të përkrahte kthimin e emigrantëve në tregun punës..

Suksesi i programit ishte i dukshëm. Gjatë shtatë viteve, jo vetëm që u punësuan mbi 5000 njerëz, por edhe shumë kompani u përkrahën me kadro të kualifikuara. Shumë ndërmarrje të vogla dhe të mesme u themeluan nëpërmjet granteve të vogla. Për më tepër, u implementuan edhe masa për kualifikim të punëkërkuarëve.

Por është një rezultat tjetër që na bën krenar dhe na jep shkas për të festuar sot:

APPK u zhvillua si implementuese lokale e programeve për Kosovën, me kompetenca të cilat janë shumë të kërkuara në Kosovë dhe jashtë saj, për implementim të programeve të ngjashme.

Zogu i vogël i familjes së AGEF-it sot është bërë një pëllumb i bardhë, i cili përhapë idenë e një të ardhme paqësore për Kosovën.

Historiku i APPK-së

Që nga viti 2004, APPK vepron si pasardhëse e organizatës AGEF Berlin, organizatë kjo nga Berlina e cila e ka themeluar përfaqësinë e vetë në Prishtinë në muajin Prill 2000. APPK është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitim prurëse e regjistruar në vitin 2001 në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve, fillimisht si degë e AGEF-it (Arbeitsgruppe Entwicklung und Fachkräfte im Bereich der Migration und der Entwicklungszusammenarbeit, Germany).



Afarizmi i organizatës ka filluar me dy punëtorë, në një sipërfaqe prej 40 m² me projektin e atëhershëm për ri-integrimin ekonomik të 600 kosovarëve të kthyer nga Gjermania, duke vazhduar pastaj në vitin 2001 me 7 punëtorë, në një sipërfaqe 120 m², me numër shtesë të projekteve. Në vitin 2003 themeloi të ashtuquajturën "Akademia për të rritur" në një objekt prej më shumë se 500 m² për të vazhduar më tej zhvillimin deri në ditët e sotme kur arriti në numrin e tërësishëm prej 35 bashkëpunëtorësh të rregullt, mbi 100 bashkëpunëtor të jashtëm dhe mbi 50 projekte të implementuara.



Struktura organizative, Bordi i drejtorëve dhe Bordi Këshillues i APPK-së

Menaxhmenti i APPK-se, Bordi i Drejtorëve si dhe Bordi Këshillues

APPK-ja ka një strukturë të qëndrueshme të menaxhimit si në aspektin e personelit ashtu edhe në procedurat dhe politikatat e menaxhimit. APPK-ja dhe partnerët e saj mbajnë përgjegjësitë e tyre për arritjen e objektivave të vendosura, si dhe për administrimin e burimeve financiare dhe njerëzore. APPK është e mbikëqyrur nga Bordi i Drejtorëve i përbërë nga Drejtori i përgjithshëm i AGEF-it, Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm i AGEF-it dhe Drejtori Ekzekutiv i APPK-së, të cilët së bashku mbikëqyrin zhvillimin e

përgjithshëm dhe punën e organizatës.

Veç kësaj, APPK-ja ka një Bord Këshillues i cili përbëhet nga 8 anëtarë të përhershëm, ku gjashtë prej tyre janë palë institucionale në nivel nacional të përfshira në tregun e punës, zhvillimin ekonomik dhe edukimin në Kosovë. Institucionet të cilat kanë përfaqësuesit e tyre në këtë Bord janë: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI),

Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK), Oda Ekonomike e Kosovës dhe Komuna e Prishtinës. Dy anëtarët e mbetur të Bordit Këshillues të APPK-së janë përfaqësues që vijnë nga komuniteti ndërkombëtar, Ambasada Gjermane dhe AGEF Berlin. Roli i Bordit Këshillues është që t'i ofrojë mbështetje të vazhdueshme menaxhmentit të APPK-së lidhur me përforcimin e kapaciteteve të saj menaxhuese dhe operacionale, si dhe në ofrimin e të dhënave mbi trendet e zhvillimeve socio-ekonomike në Kosovë.

APPK-ja përbëhet nga disa departamente, të cilët mbulojnë funksionet e mëposhtme:

- Ndërmjetësim në punësim (këshillim, orientim dhe ndërmjetësimin e punëkërkesve);
- Financat dhe Kontabilitetin;
- Biznese dhe trajnime profesionale;
- Shërbimet e rekrutimit;
- Shërbimet e këshillë-dhënies në fushën e menaxhimit, duke përfshirë menaxhimin e projekteve, themelimin/zhvillimin e bizneseve, prokurimin, etj





Misioni, vizioni dhe vlerat e APPK-së

➤ Vizioni:


Që nga viti 2004, APPK vepron si pasardhëse e organizatës AGEF Berlin, organizatë kjo nga Berlina e cila e ka themeluar përfaqësinë e vetë në Prishtinë në muajin Prill 2000. APPK është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitim prurëse e regjistruar në vitin 2001 në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve, fillimisht si degë e AGEF-it (Arbeitsgruppe Entwicklung und Fachkräfte im Bereich der Migration und der Entwicklungszusammenarbeit, Germany).

➤ Vlerat:

Integriteti i personelit, politikat jo-diskriminuese; vetëdija për çështjet gjinore, transparenca e veprimeve, fleksibiliteti, kompetenca, përkushtimi, puna grupore, përgjegjshmërinë, cilësia, orientimi ndaj klientit.

➤ Misioni:

Përmes ofrimit të ndihmës në (re)integrimin socio-ekonomik dhe zhvillimin e kapaciteteve APPK-ja kontribuon në qëndrueshmërinë e grupeve të synuara, promovon zhvillimin ekonomik, dhe inkurajon dialogun ndër-etnik dhe pajtimin përmes bashkëpunimit ekonomik, gjithmonë duke pasur parasysh çështjet gjinore, të rinisë, shoqërisë civile dhe ato mjedisore.



➤ Koncepti i biznesit dhe klientët

➤ KONCEPTI I BIZNESIT

➤ Kompetencat kryesore

- Staf profesional dhe i trajnuar për lëmi të ndryshme në të cilat zhvillojmë aktivitetet tona
- Përshtatje e shërbimeve dhe aktiviteteve, varësisht nga kërkesat e klientit/grupit synues/tregut
- Monitorim dhe vlerësim i vazhdueshëm i performacës dhe rezultateve të projekteve të implementuara
- Komunikim efektiv me përfituesit dhe donatorët

➤ Përparësitë konkurruese

- Fleksibilitet dhe cilësi e lartë e shërbimeve si rezultat i përvojës së gjatë në implementim të projekteve të ndryshme
- Qasje profesionale ndaj klientit

➤ KLIENTËT

- Individët dhe grupet të cilat kanë vështirësi me integrimin në shoqëri dhe ekonomi.
- Individët të cilët janë të përkushtuar për avancimin e vazhdueshëm profesional/ të karrierës,
- Qytetarë kosovarë të cilat synojnë integrim në shoqëritë/tregjet e vendeve të BE-së, në veçanti Gjermanisë
- Kompanitë, organizatat dhe institucionet të cilat janë të interesuara dhe të përkushtuara për zhvillim të burimeve njerëzore
- Kompanitë, organizatat dhe institucionet të cilave iu duhet përkrahje për planifikim, organizim dhe menaxhim të eventeve të ndryshme siç janë konferencat, seminarët, workshopet, trajnimet.



Objektivat dhe aspiratat

- ▶ Investimi i vazhdueshëm në zhvillimin e kapaciteteve
- ▶ Hartimi dhe implementimi i projekteve të (re)integrit të cilat marrin parasysh nevojat specifike të grupeve synuese, në përputhje me kërkesat e tregut,
- ▶ Ofrimi i përkrahjes për donatorët kombëtarë dhe ndërkombëtar për identifikimin e fushave/projekteve të cilat mbulojnë nevoja të veçanta e të cilat premtojnë (re)integrit të qëndrueshëm.
- ▶ Të bëhet një lojtar aktiv në aktivitetet e hartimit të politikave në fushën e (re)integritit socio-ekonomik dhe zhvillimit të kapaciteteve.
- ▶ Të bëhet zgjedhje e parë për të gjithë donatorët të cilët investojnë në projektet socio-ekonomike dhe në ato të zhvillimit të kapaciteteve.





Partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë

➤ Marrëdhëniet me partnerët implementues dhe palët e interesit

APPK-ja ka një histori të dëshmuar të punës me organizatat ndërkombëtare, institucionet e Kosovës, dhe organizatat tjera në Kosovë si një partner implementues i projekteve për (re)integrimin ekonomik. Në veçanti, APPK është e përfshirë në organizimin, administrimin dhe menaxhimin e eventeve të ndryshme, përfshirë këtu seminare, workshope, konferenca, trajnime, provime, etj. APPK dhe AGEF ka arritur të

nënshkruajë Memorandum Mirëkuptimi me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministrinë për Komunitete dhe Kthim. Gjithashtu ka krijuar lidhje të mira pune me Odën Ekonomike të Kosovës, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, si dhe rrjetin e qendrave të trajnimeve dhe organet publike dhe komerciale. APPK-ja bashkëpunon me Ambasadën Gjermane në Kosovë, UNDP-Kosovë si dhe organizatat tjera ndër-kombëtare

brenda dhe jashtë Kosovës. APPK-ja bën implementimin e projekteve me ekipin e vet menaxhues dhe stafin, të përbërë nga 35 persona, përfshirë këtu këshilltarët në gjashtë (6) zyre regjionale dhe trajnerët. APPK-ja bën implementimin e projekteve së bashku me rrjetin e krijuar të partnerëve implementues lokalë dhe të ekspertëve, bazuar në nevojat specifike të përfituesve të synuar.

➤ Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile të komuniteteve jo-shumicë

APPK bashkëpunon me një numër të konsiderueshëm të OJQ-ve të komuniteteve jo-shumicë, në fushën e trajnimit dhe (re)integrimit socio-ekonomik. Lista e këtyre OJQ-ve dhe projekteve të implementuara me ata përfshin:

- OJQ "ROM" - Prizren- Përkrahja në ndërtimin dhe menaxhimin e Qendrës për Komunitete - Prizren
- OJQ "Gratë për Gra" - Trajnimi i punëkërkueseve femra nga zonat rurale
- OJQ "Shoqata për gratë në biznes" Mitrovicë- Trajnime për (vet)punësime për komunitetet minoritare.
- OJQ "CSD" - Graçanicë- Trajnimi në qasjen ndaj minoriteteve pakicë.



Të gjitha aktivitetet dhe shërbimet e APPK-së mund të grupohen në katër kategori kryesore:

- ▶ **(Re)integrimi socio-ekonomik, me elemente të përkrahjes së zhvillimit ekonomik**
- ▶ **Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore**
- ▶ **Menaxhimi i eventeve dhe**

▶ **(Re)integrimi socio ekonomik dhe përkrahja e zhvillimit ekonomik**

Aktivitetet e (re)integrimit socio-ekonomik APPK i zhvillon në bazë të projekteve të financuara nga donatorët e ndryshëm. Instrumentet të cilat shfrytëzohen për (re)integrimin socio-ekonomik të individëve nga grupet e paracaktuara synuese janë ndërmjetësimet e kuadrit profesional

apo ndërmjetësimet në punësim (NKP), aftësimet e mëtejme profesionale me qëllim ndërmjetësimin në punësim dhe përkrahja e themelimit/zhvillimit të afarizmit privat.

Të gjitha këtyre instrumenteve iu paraprijnë këshillimet dhe trajnimet orientuese profesionale.

▶ **Këshillimet-Trajnimet orientuese profesionale**

Punëkërkuesve iu ofrohen informacione për vendet e lira të punës, mënyrën e konkurrimit, tregun e punës në tërësi, aftësimet profesionale si mënyrë për të arritur deri tek punësimi dhe mundësitë e themelimit të bizneseve.

Trajnimet Orientuese realizohen varësisht prej projekteve të aranzhuara, ku gjatë një trajnimi orientues disa ditor, punëkërkuesi trajnohet për mënyrën e konkurrimit (përpilimin e

dokumenteve konkurruese, mënyrën në të cilën zhvillohen bisedat prezantuese apo intervistat), pastaj përfitohen njohuri për tregun e punës, ekonominë Kosovare, ligjet e ndryshme në Kosovë të cilat e mbulojnë sferën e punësimit dhe sferën sociale. Me këto njohuri të fituara, kandidati e realizon orientimin e vetë profesional dhe e rritë shansin për ri-integrim të suksesshëm ekonomik në shoqëri.



► Aftësimet e mëtejme profesionale për punëkërkuës

Me synim të ndërmjetësimit në punësim dhe në përputhshmëri me kërkesat e identifikuara paraprakisht nga tregu i punës, ofrohen aftësimet (trajnimet) profesionale për disa profesione si: asistente administrative, asistent marketingu, asistente të edukatoreve, administratorë të rrjeteve kompjuterike, kontabilitet, trajnim i trajnerëve, trajnim i

kombinuar (gjuhë angleze, kompjuter, korrespondencë moderne, kontabilitet aplikativ), trajnime nga IT-ja, kurse të gjuhës Gjermane "Start Deutsch 1", Trajnime të formës "Trajnim të kombinuar" dhe trajnime tjera varësisht nga kërkesat e tregut të punës. Pas përfundimit të trajnimit, bëhet vlerësimi i njohurive të arritura e pastaj kandidatëve iu ofrohet shërbimi i ndërmjetësimit në punësim.



► Ndërmjetësimi në punësim i kuadrove profesionale

APPK ofron shërbime të ndërmjetësimit në punësim për kuadrot profesionale në cilësinë e konkurruesit për punë në njërinë dhe punëdhënësve në anën tjetër, duke i ndërlidhur në këtë mënyrë interesat e të dy palëve, për një

punësim të qëndrueshëm dhe përkrahje të zhvillimit ekonomik. Varësisht prej projektit, ndërmjetësimi në punësim mund të përkrahët në formë të participimit në të ardhurat personale për të punësuarin për një periudhë të caktuar kohore.



► Përkrahja e themelimit/zhvillimit të afarizmit privat

Në rastet kur kandidati posedon parakushte të konsiderueshme për të themeluar një afarizëm privat, atëherë përmes këshillimeve dhe trajnimeve "Si ta themeloj dhe zhvilloj Biznesin" por edhe me përkrahje financiare (varësisht prej projekteve), kandidati përkrahet në themelimin e biznesit të tij.

Përveç përkrahjes së individëve që posedojnë parakushte për themelimin të afarizmit privat, përkrahja iu ofrohet poashtu edhe individëve që tashmë kanë një afarizëm por që kanë nevojë

për ndihmë në zhvillimin e mëtejshëm të tij. Varësisht nga projektet, individëve të përkrahur iu ofrohet edhe një numër i caktuar i orëve të konsulencës pas përkrahjes fillestare.

Me mbi 5500 ndërmjetësime në punësim, me aftësimet e mëtejshme profesionale të mbi 1100 punëkërkuësve, certifikimin e mbi 2000 kandidatëve tjerë në disa profesione si dhe me përkrahjen e themelimit të mbi 2200 bizneseve private, APPK-ja paraqet sot organizatën më profesionale në Kosovë për përkrahjen e ri-integrimit socio-ekonomik të individit.



► Disa prej projekteve kryesore të implementuara nga APPK në fushën e (re)integrimit socio-ekonomik dhe donatorët përkatës

- (Re)integrimi socio-ekonomik i pjesëtareve të ish-TMK-së - Fondi i Mirëbesimit të NATO-s
- Ofrimi i asistencës socio-ekonomike për të kthyerit individual - UNDP
- Trajnimi i 240 kandidatëve për zhvillim të bizneseve - IOM
- (Re) integrimi socio-ekonomik i 35 të kthyerve nga Danimarka - Qeveria Däneze
- (Re) integrimi socio-ekonomik i mbi 100 kosovarëve - UNDP Kosove
- Përkrahja në themelimin dhe zhvillimin e 173 ndërmarrjeve të vogla - BMZ/AGEF Berlin
- Përkrahja në themelimin dhe zhvillimin e 33 ndërmarrjeve të vogla - SDC Switzerland
- Ndërmjetësimi në punësim i 60 punëkërkuësve - SDC Switzerland
- Ndërmjetësimi në punësim i 1470 të kthyerve nga Gjermania - BMZ/AGEF Berlin
- Trajnim profesional i 93 punëkërkuësve - AA/AGEF Berlin
- Trajnim profesional i 48 punëkërkuësve - BAMF/AGEF (Berlin)
- Trajnim profesional i 190 punëkërkuësve - BMZ/AGEF Berlin

► Integrimi socio ekonomik i individëve që synojnë bashkimin familjar në Gjermani

Ekziston edhe një grup synues i cili përkrahet për integrimin socio-ekonomik. Është ky grupi i individëve të cilët synojnë migrimin në Gjermani me qëllim të Bashkimit familjar. APPK-ja synon që ta lehtësojë integrimin e tyre në shoqërinë gjermane përmes ofrimit të kurseve të gjuhës gjermane dhe përmes implementimit të një projekti të organizatës Diakonisches Werk Baden Württemberg.



► Kurset e gjuhës gjermane

Shteti Gjerman që nga muaji gusht 2007 ka sjellë një vendim me të cilin parasheh që qytetarët e vendeve të ndryshme të Botës të cilët synojnë shkuarjen në Gjermani me qëllim të "Bashkimit Familjar", me rastin e paraqitjes së kërkesës për vizën pranë ambasadës përkatëse, në mes tjerash janë të obliguar që të paraqesin dëshminë përkatëse se e njohin nivelin e parë (A1) të gjuhës

Gjermane. Goethe-Institut, është instituti Gjerman të cilit i është besuar organizimi dhe implementimi i provimeve përkatëse përmes së cilit kandidatët në rast të dhënies së suksesshme të provimit të pajisjen me Certifikatën "Start Deutsch 1". Që nga Nëntori 2007, me rekomandim edhe të Ambasadës Gjermane, ky institut është duke i implementuar këto provime në objektet e APPK-së, me përkrahjen

e përgjithshme organizative, administrative dhe logjistike të APPK-së. APPK-ja që nga muaji Nëntor 2007, ka filluar organizimin dhe implementimin e kurseve të gjuhës Gjermane. Mbi 2000 kursistë (gjer në muajin dhjetor 2009) dhe një kalueshmëri prej mesatarisht 80%, janë vetëm dy elemente të cilat paraqesin indikatorët e suksesit të këtyre kurseve.

► Diakonisches Werk Baden Württemberg

Diakonisches Werk Baden Württemberg, i financuar nga fondi i integritit evropian – EIF, ka marrë përsipër përkrahjen e Integritit të individëve në Gjermani. Projekti ka filluar më 01.01.2009. Për një integrim të mirë dhe të shpejt në Gjermani krahas mësimit të gjuhës është e rëndësishme edhe një para-përgatitje për jetën sociale,

ekonomike dhe kulturore. Një përgatitje e tillë sistematike për „emigrim“ përkatësisht "imigrim" në Gjermani deri më sot nuk ekziston. Në këtë pilot projekt duhet të testohet një program i tillë përgatitor. Projekti synon, që personat, të cilët dëshirojnë të shkojnë në Gjermani për bashkim familjar, të i përgatis në atdheun e tyre për emigrim dhe jetën në

Gjermani. Me këtë, procesi i integritit përkrahet fuqishëm. Parallel me ofertat për kurse të gjuhës Gjermane do të ketë oferta shtesë për një këshillim për emigrim/imigrim (informata për një vend, krijimi i një dosje për aplikim, sigurimi i informatave për vendbanimin e ardhshëm...)

Përkrahje punëdhënësve

➤ Aftësimet e mëtejme profesionale për të punësuarit – zhvillimi i kapaciteteve njerëzore

Duke u bazuar në faktin që në botën moderne, resurset njerëzore paraqesin komponentin kryesor për suksesin e ndërmarrjes, organizatës apo institucionit, APPK-ja, ofron këshillime për ANT (Analiza e Nevojave të Trajnimeve) për të punësuarit e një punë-dhënësi, duke bërë krah-asimin në mes të kualifikimit dhe përvojës së punë-marrësit

në njërën anë dhe kërkesave të vendit të punës në anën tjetër. Në bazë të identifikimeve paraprake, bëhet dizajni i trajnimeve të mëtejme profesionale me synim të avancimit të njohurive të të punësuarve si një prej faktorëve kryesor në prosperitetin e Ndërmarrjes, Organizatës apo Institucionit.



Trajnimi i mëtejme profesional i bashkëpunëtorëve të firmave si Gorenje, Pro Credit Bank, Install Ingeniering, PTK, KEK, apo të institucioneve si MPMS (Ministria e Punës) MSHP (Ministria e Shërbimeve Publike), MSH (Ministria e Shëndetësisë) janë vetëm disa prej 400 të punësuarve të trajnuar gjer më tani nga APPK-ja.

► Këshillime profesionale për zhvillimin e mëtejshëm të afarizmit

Ndërmarrjeve Kosovare iu ofrohen konsultime në aspektin e zhvillimit të resurseve njerëzore, menaxhmentit, zhvillimit të partneritetit, bashkëpunimit vendor dhe ndërkombëtar (me theks të veçantë me Gjermaninë). APPK, në bazën e të dhënave posedon të dhënat e mbi 2500 ndërmarrjeve Kosovare nga lëmit e ndryshme.

► Projektet kryesore të implementuara nga APPK në fushën e zhvillimit të kapaciteteve njerëzore dhe donatorët përkatës

- Trajnim i mëtejshëm profesional i 85 punonjësve të Ministrisë së Shëndetësisë- CCNE
- Trajnim i mëtejshëm profesional i 42 punonjësve të Ministrisë së Punëve të Brendshme- ATOS Consulting
- Trajnim i mëtejshëm profesional i 25 punonjësve të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural- KOPF
- Trajnim i mëtejshëm profesional i 12 punonjësve të Pro Credit Bank – PCB



➤ Organizimi dhe menaxhimi i eventeve

Rreth 100 seminare, punëtori (workshope), takime dhe evente kulturore organizohen, përkrahen dhe menaxhohen nga APPK-ja brenda vitit. Gjatë 6 viteve të fundit, APPK-ja ka organizuar evente për një numër të madh klientësh, përfshirë këtu ministritë e Kosovës (siç janë Ministria e Bujqësisë, Ministria e Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë), kompanitë e

qëndrueshme publike dhe private dhe institucionet si Raiffeisen Bank, ProCredit Bank dhe organizatat ndërkombëtare si UNMIK, OSBE, Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Teknik (GTZ), Swissinfo dhe British Council. Një ndër bashkëpunimet më të suksesshme në fushën e organizimit dhe menaxhimit të eventeve është ai me Fondin European për Trajnime (ETF), i cili daton që nga viti 2006 dhe ende

vazhdon. Zyra qendrore e APPK-së posedon hapësira për trajnime dhe evente të ndryshme. Përveç mjeteve të TI-së (projektorë shënimesh dhe me ndriçim, panele te bardha, projektorë filmik, sistem zërimi përfshirë mikrofonat, mbajtësen e mikrofonit dhe zmadhuesit e zërit), gjithashtu posedon mjetet për përkthim, përfshirë këtu edhe kabinën e përkthimit.





- ▶ APPK është në gjendje që në afat të shkurtër kohor të kontraktojë profesionistë të kualifikuar siç janë përkthyesit dhe ekspertët e lëmive të ndryshme.
- ▶ APPK ka një përvojë të gjatë në organizmin, menaxhimin dhe përkrahjen e eventeve të mëdha dhe komplekse të ndërlidhura me zhvillimin e mëtejshëm të sistemit arsimor dhe sistemit të punësimit, me hartimin e politikave për ngritje të kapaciteteve njerëzore, etj.

Xpert

➤ Certifikimet

APPK që nga viti 2004 ofron certifikime nga fusha e teknologjisë informative. Fillimisht u certifikua si qendër testuese për sistemin Xpert, bashkëpunimi me të cilin vazhdoi deri në vitin 2009. Që nga prilli 2010 APPK u certifikua si qendër testuese e European Computer Driving License ECDL.

➤ Pasaporta Evropiane për Kompjuter Qendra Evropiane e Testimit ne Hanover paraqet sistemin Xpert

Si institucioni i pare i këtij lloji ne Gjermani, Qendra Evropiane e Provimit ne Hanover ka zhvilluar konceptin e kursit profesional dhe te provimit për tregun e punës qe ne vitin 1982. Kjo përvoje e pasur ka rezultuar ne krijimin e Pasaportës Evropiane te Xpert-it ne Kompjuter, qe përfaqëson një kualifikim te standardit me te larte. APPK-ja ishte qendra e vetme e licencuar për sistemin Xpert ne Kosove dhe gjate viteve të bashkëpunimit lëshoi 850 certifikata për module të ndryshme të këtij sistemi.



► European Computer Driving License - ECDL

Në fillim të vitit 2010 APPK filloi bisedimet me ECDL Kosova për të shqyrtuar mundësinë e certifikimit si qendër testuese e ECDL. APPK vendosi të ndërmarrë një hap të tillë si rezultat i kërkesave të tregut dhe për faktin se ECDL –i është sistemi i rekomanduar nga BE-ja për zyrtarët e administratës publike.

Falë profesionalizmit, përvojës së gjatë e të begatshme të APPK-së në këtë lëmi, si dhe plotësimit të kushteve infrastrukturore, ajo u certifikua si qendër trajnuese/testuese për ECDL në Prill të vitit 2010.

► Modulet e ECDL-it të cilat ofrohen nga APPK-ja janë:

- Moduli 1 - Bazat e Teknologjisë Informative (IT)
- Moduli 2 - Windows XP - Shfrytëzimi i kompjuterit dhe menaxhimi i fajllave
- Moduli 3 - MS Word - Përpunimi i teksteve
- Moduli 4 - MS Excel - Kalkulimi i tabelave
- Moduli 5 - MS Access - Bazat e të dhënave
- Moduli 6 - MS Power Point – Prezantimet
- Moduli 7 - Bazat e Internetit - MS Explorer 6.x dhe MS Outlook



Ahmet Rafuna



Rafuna me familjen e tij ka shkuar në Gjermani në vitin 1993. Atje ka qëndruar 7 vite. Gjatë qëndrimit atje ka vijuar edhe aftësimet profesionale për automekanik. Pas kthimit në Kosovë, përmes programeve të AGEF-APPK-së, është ndër-mjetësuar tek firma OPEL R, në të cilën firmë janë ndër-mjetësuar edhe dy kandidatë tjerë. Si profesionist i kësaj pune, ka ndikuar që firma të rrisë



numrin e klientelës dhe të ketë një zhvillim të hovshëm ekonomik. Ahmeti para 2 vitesh , së bashku me familjen e vet, ka hapur biznesit e tij privat, në të njëjtën lëmi për mirëmbajtjen e automjeteve kryesisht të firmës OPEL. "Profesionalizimi dhe përkushtimi në punë, krijon mundësi të mira të veprimtarisë dhe jetës së mirë ekonomike në Kosovë"- thekson Ahmeti.

Musa Kadriu



Pas qëndrimit në Gjermani prej vitit 1998 deri në vitin 2002, kthehet në Kosovë. Duke u bazuar në kualifikimet e tij prej elektro-inxhinieri, ekipi i APPK-së ka hulumtuar disa vende të lira të punës dhe pas disa negociatave arrihet të realizohet ndër-mjetësimi i suksesshëm në KOSTT (KEK) në vitin 2003. Në fillim punon si praktikant, kurse pas dy vitesh avancohet si menaxher i sektorit për mirëmbajtjen e relesë. "Disiplina në punë, e fituar gjatë viteve të qëndrimit në Gjermani, ishte një ndër faktorët kryesorë

për ballafaqim të suksesshëm me sfidat e vendit të ri të punës. Gjuha gjermane e mësuar atje, ishte gjithashtu një element tjetër pozitiv për punën e re në Kosovë" deklaroi Musa. Musa se bashku me bashkëshorten Elhemën e cila gjithashtu në vitin 2003 është ndër-mjetësuar në punësim përmes AGEF-it dhe atë në Entin Poliklinik Ambulator ERL, sot janë shumë të kënaqur që janë integruar ekonomikisht, dhe kontribuojnë në ndërmarrjet e tyre si kuadro profesionale.



Gëzim Gegaj



Gjatë qëndrimit të tij në Gjermani ka punuar 1 vit në lulishte dhe 2 vite në fabrikën për prodhimin e betonit. Pas kthimit në Kosovë, në vitin 2002, AGEF-i ka hulumtuar vende të lira të punës, ashtu që duke iu falënderuar përvojës së tij, ka arritur ta ndërmjetësojë në një vend të ngjashëm pune - në fabrikën e betonit OTI Group.

Ndërmarrja ku punon që 8 vite, tani e ka zgjeruar veprimtarinë e vetë dhe është një ndërmarrje shumë e suksesshme. Përveç punës së tij si menaxher, Gëzimi ka themeluar edhe kompaninë e tij private për prodhimin e deryeve dhe dritareve të plastikës dhe fasadave



Afrim Krasniqi



Nga Vushtrria është njëri prej mijëra Kosovarëve që në vitet para luftës ka migruar në Gjermani. Etje ka qëndruar 8 vite. Në vitin 2000 kthehet në Kosovë dhe paraqitet në AGEF me qëllim të përkrahjes në ri-integrimin e tij në shoqërinë Kosovare. Duke u bazuar në shkollimin e tij si një ekonomist i diplomuar, dhe duke u bazuar në kërkesat e tregut të

punës, AGEF-i në kuadër të programeve të trajnimeve profesionale të financuara nga BMZ/ZAV, ia ofron Afrimit mundësinë për të përcjellur trajnimin katër-mujor (Shtator-Dhjetor 2001) për kontabilitet. Në kuadër të grupit, që përbante edhe 14 kandidatë tjerë, Afrimi nën trajnimin e ekspertit nga Gjermania z. Horst Hoffmann,

është aftësuar profesionalisht për udhëheqjen e Kontabilitetit me standarde ndërkombëtare. Pas trajnimit, Afrimi e ushtroi zanatin e vet në firmën "Kontabiliteti", kurse prej vitit 2002 ushtron detyrën e Koordinatorit të Tatimeve në njërin prej kompanive më të suksesshme në Kosovë - PTK (Post Telekom i Kosovës).



Grupi i trajnimit ku ka qenë Afrimi



Medain Hashani

➤ Është njëri prej 15 kandidatëve, të cilët në vitin 2002, në kuadër të projektit të financuar nga AA (Ministria e jashtëm e Gjermanisë), kanë vijuar modulën trajnues dy-mujor “Trajnimi i Trajnerëve”. Medaini iu bashkëngjiti këtij grupi me qëllim që duke i avancuar metodat e trajnimit, të aftësohet edhe më tutje në mënyrë që përvojën dhe njohurinë e tij, ta transferoj në formë sa më produktive tek të tjerët. Medaini gjer më tani ka mbajtur trajnime

me mbi 30 grupe të ndryshme. Këto ishin trajnime shumë të suksesshme në lëmin e kontabilitetit dhe analizës financiare. “Nga kontaktet që kam me kandidatët, kam kuptuar se duke iu falënderuar këtyre trajnimeve, pothuajse të gjithë ata janë punësuar dhe integruar ekonomikisht” deklaroi Medaini. Sot punon si drejtor financiar në Pallatin e Rinisë, Kulturës dhe Sporteve në Prishtinë si dhe ligjërues në Fakultetin Ekonomik.



Selvetë Grajçevci

➤ •Ka migruar në Gjermani në vitin 1998 dhe është kthyer në Kosovë në vitin 2003. Në kuadër të programeve për përkrahjen e ri-integrimit ekonomik të të kthyerve nga Gjermania, të implementuar nga APPK-AGEF, Selvetja në vitin 2004 ka vijuar trajnimin tremujor për “Kompiuter, Gjuhë Angleze dhe Komunikim. Pas përfundimit të trajnimit dhe stabilizimit familjar, punësohet në firmën SUPERMIX, një firmë e cila prodhon specialitete të brumërave sipas recetave nga shteti Gjerman.



Duke u bazuar në njohuritë e saj dhe trajnimet e përcjellura, znj. Grajçevci paraqet për punëdhënësin e saj njërin prej punëtoreve shumë profesionale. “Qasja ndaj klientëve, kultura e punës e sjellur nga Gjermania, dhe komunikimi në disa gjuhë (gjermane, angleze dhe serbe), janë vetëm disa prej elementeve që znj. Grajçevci e bëjnë një punëtore shumë të vlefshme për firmën”- shprehet menaxheri i saj. Burim Mustafa.

Ermira Sadiku



Ka migruar në Gjermani së bashku me familje në vitin 1994. Atje vazhdoj dhe përfundoj shkollimin fillor dhe atë të mesëm. Pas kthimit në Kosovë në vitin 2004, ajo inkuadrohet në programet trajnuese të ofruara nga AGEF-APPK për "Teknike Administrative". Pas përfundimit të suksesshëm të trajnimit realizon një punë praktike në APPK, kurse që nga viti 2008 punon si asistente administrative në njërin prej firmave më të suksesshme në Kosovë - Xella, e



cila merret me prodhim të bllokova dhe tullave silikate SILKA. XELLA sot mbulon tërë tregun e Kosovës si dhe atë maqedon dhe shqiptar.

Sa i përket punë së Ermirës, punëdhënësi i saj z Krasniqi, shprehët se " Përgatitja profesionale, njohuritë dhe përvoja e fituar gjatë shkollimit dhe jetës në Gjermani, kanë ndikuar shumë pozitivisht që Ermira t'i kryejë me sukses të gjitha punët e parapara për pozitën e saj.

Sabri Azemi



Pas një konsultimi me bashkëpunëtorët e AGEF-it në vitin 2002, përzgjidhet për të marrë pjesë në një seminar për themelimit biznesi. Ai filloi trajnimin 10-ditor me idenë për të themeluar një firmë e cila ofron shërbime specifike - Shpime nëntokësore horizontale. Gjatë trajnimit ai së bashku me trajnerin elaboroi të gjitha aspektet ekonomike të themeimit dhe zhvillimit të biznesit . Plani i tij i biznesit u vlerësua si plan i qëndrueshëm ekonomik

nga ekspertë të AGEF-it, kështu që në kuadër të programeve përkrahëse të DEG/AGEF, ai u përkrahë edhe financiarisht. Sabriu themeloi firmën "Raketa" dhe bleu pajisje nga Gjermania. Në këto 8 vite veprimi ai zgjeroi mekanizmin e firmës me pajisje deri në vlerë prej 50.000 euro, punësoi 4 punëtorë të rregullt dhe gjer më tani arrin të bëjë mbi 80 shpime në vit, në të gjitha anët e Kosovës.



Jahi Veseli



Pas kthimit të tij nga Gjermania në vitin 2005, paraqitet në AGEF-APPK. Pas një konsultimi të detajuar me ekspertët e APPK-së, vlerësohet se ai posedon të gjitha parakushtet për të zhvilluar një afarizëm privat në lëmin e bujqësisë dhe blegtorisë. Në mars 2006, vijon një seminar për themelimit biznesi, gjatë të cilit fokusohet në zhvillimin e blegtorisë me synim që nga ky zhvillim të avancoj edhe punët e bujqësisë. Gjatë vlerësimit të biznes planit të tij, është konsta-

tuar se zgjerimi i fermës ekzistuese edhe me disa krerë lopë do ta avancojë tutje afarizmin e tij. Nga 4 krerë lopë sa i kishte, nga përkrahja e prog-ramit përfiton mundësinë e blerjes edhe të 6 krerëve tjera.

Me zhvillim të biznesit të tij, Jahi se bashku me bashkëshorten që e përkrah vazhdimisht, ka arritur ta kompletojë tërë mekanizimin e nevojshëm bujqësor, pasi që brenda vitit ai arrin të shesë mbi 600 kg djathë, 4000 litra qumësht por edhe 6-8 krerë viça.

Nesret Shashivari



Nga komuna e Shtimes ka qenë i inkuadruar në TMK qysh nga fillimi i saj. Gjatë misionit të tij në TMK, z. Nesret Shashivari gradohet si Kapter. Pas shpërbërjes së TMK-së dhe formimit të FSK-së, ai nuk mundi ta jetësojë idealin dhe ëndrrën e tij për të kontribuar edhe në FSK. Gjatë zhvillimit të aktiviteteve të Programit për Ri-sistemim, u vlerësua se Nesreti i posedon të gjitha parakushtet për të zhvilluar një afarizëm privat në lëmin e shërbimeve të gomisterisë. Në maj të vitit 2009 vijoi një seminar

për themelimit biznesi. Gjatë vlerësimit të programit të tij, u konstatua se ai mund të fillonte veprimtarinë e tij afariste, meqenëse posedonte disa pajisje bazë dhe lokalim prej 200 m² i cili gjendet në rrugën tranzit në Shtime (magjistralja Prishtinë-Prizren), ndërsa k Duke u nisur nga vullneti për të udhëhequr një biznes të vogël por të suksesshëm ai e regjistroi atë pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, me emrin D.P.Z " Te Muli". Nga përkrahja që iu ofrua nga Programi, ai mbuloi një pjesë të

madhe të shpenzimeve për blerje të pajisjeve për gomisteri. Nesreti së bashku me të vëllain që e përkrah vazhdimisht, ka arritur ta funksionalizojë veprimtarinë e tij si gomister duke realizuar të hyra të kënaqshme për këtë periudhë kohore.



Sabit Shuplja



Familja e tij emigruan nga Kosova në vitin 1992 duke shpresuar për një jetë më të mirë. Danimarka ishte vendi i cili iu ofroi strehim, por në vitin 2008, Sabiti me familje u kthyen ne Kosovë. APPK/AGEF si partner i kontraktuar nga Danish Refugee Council për re-integrimin ekonomik filloi aktivitetet me Sabitin. Që nga fillimi i këtyre aktiviteteve, Sabiti kishte qëndrim pesimist për të ardhmen. Megjithatë, pas këshillimeve me këshilltarët e APPK AGEF, Sabiti vendosi të themeloj një biznes privat, që do të ofronte shërbime në fushën e transportit, konkretisht shërbime prej taksisti. Sot Sabit Shuplja punon me kombi-

bus dhe është taksist shumë i njohur në zonën e Dragashit. posaçërisht për personat, të cilët




kanë punë të ndryshme në për Ambasada. Ai është shume mirë i informuar për oraret dhe procedurat e ndryshme të cilat aplikohen në ambasadat e ndryshme, gjë që e rrit vlerën e shërbimeve që ai ofron, duke e bërë më të përshtatshëm për klientët sesa ofruesit tjerë të shërbimeve nga e njëjta fushë. Ai mbanë linjën e rregullt të transportit nga fshati Restelicë deri në Dragash. Sipas tij, ai arrin që brenda muajit të gjenerojë një shumë prej 450-650 euro, që është më se e mjaftueshme për standardin e jetesës në zonat rurale të Kosovës.

Liridona Aliqku



Nga Prishtina u martua vitin e kaluar, por ekzistonte një pengesë të cilën ajo duhej kaluar për të filluar jetën bashkëshortore. I zgjedhuri i saj jeton dhe punon në Gjermani, ndërsa Liridona duhet të aplikojë për vizën për bashkim familjar, në mënyrë që t'i bashkëngjitet atij. Siç është e njohur tashmë, për të marrë vizë të kësaj kategorie në Gjermani parakusht kryesor është paraqitja e certifikatës së Goethe Institut për njohje të nivelit të parë – A1 të gjuhës gjermane. Fatkeqësisht, Liridona nuk kishte as njohuri bazike të gjuhës gjermane, prandaj kjo paraqiste një sfidë jo të

vogël për të. Si rezultat i kësaj, ajo u paraqit në APPK AGEF me qëllim që të vijonte kurset e gjuhës gjermane, të përshtatura posaçërisht për persona që kanë të njëjtin synim si ajo, pra bashkimin familjar në Gjermani. Pas më pak se tre muajsh , Liridona ishte plotësisht e aftë për komunikim të përditshëm në gjuhën gjermane. Pas përfundimit të kursit të gjuhës gjermane, ajo përfitoi edhe nga projekti i Diakonisches Werk Baden Württemberg, që ka për qëllim parapërgatitjen për jetën sociale, ekonomike dhe kulturore të individëve që synojnë bashkimin familjar në Gjermani.. Si rezultat i



këtij bashkëveprimi në mes të Liridonës dhe trajnerëve të APPK-së, ajo ia doli ta kalojë provimin e Goethe Institut me sukses të lartë, për të cilin edhe ajo vetë ishte befasuar për të mirë. Ajo shprehet se tanimë është plotësisht e gatshme për emigrim në Gjermani dhe për përballje me situatat e përditshme të jetës atje.

➤ Programi për ri-sistemimin e pjesëtarëve të ish-tmk-së

Programi për ri-sistemimin e pjesëtarëve të TMK-së është hartuar me qëllim që t'i ndihmojë pjesëtarët e ish-TMK-së, të cilët pas shpërbërjes së saj, për arsye të ndryshme nuk i janë bashkuar FSK-së (Forcës së Sigurisë së Kosovës), që të ri-sistemohen në jetën civile. Ky program tre-vjeçar financohet nga Fondi i Mirëbesimit të NATO-s, ndërsa Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) është përzgjedhur për të menaxhuar Programin për Ri-sistemimin e pjesëtarëve të TMK-së.

Programi për Ri-sistemim përbëhet nga dy komponente: Pagesa për kompensim të shkëputjes nga marrëdhënia e punës dhe përkrahja për ri-integrim ekonomik. UNDP-ja do të menaxhojë pagesën e shkëputjes nga puna për pjesëtarët e TMK-së të cilët kanë të drejtë të jenë pjesë e Programit. Pagesa për shkëputje nga puna është e barasvlefshme me një pagë 12 mujore (bazuar në pagën mesatare të individit gjatë 12 muajve të fundit të shërbimit në TMK) dhe do të paguhet çdo muaj pas çmobilizimit individual.

Ndërsa, Agjensioni i Përkrahjes së Punësimit në Kosovë (APPK) është partner vendor i UNDP-së, përgjegjës për të ofruar mbështetje për ri-integrimin ekonomik.

➤ Ri-integrimi ekonomik synohet të arrihet nëpërmjet instrumenteve vijuese:

- Ndërmjetësimi në punësim
- Trajnim i mëtejshëm profesional (i kombinuar me përkrahje në punësim)
- Themelimi/zhvillimi i afarizmit privat



► **Ri-integrimi ekonomik synohet të arrihet nëpërmjet instrumenteve vijuese:**

ECDL – European Computer Driving Licence është kualifikim i pranuar ndërkombëtarisht, i cili jumundëson individëve të vërtetojnë diturinë e tyre në aftësitë dhe njohuritë kompjuterike. ECDL pranohet si standard prej më shumë se 140 shteteve evropiane dhe botërore.

► **Ri-integrimi ekonomik synohet të arrihet nëpërmjet instrumenteve vijuese:**

Metoda fleksibile e të mësuarit nënkupton që kandidati është i lire të zgjedh renditjen për mbajtjen e provimeve të moduleve përkatëse, Qendrën testuese, si dhe metodën e trajnimit. Kandidati mund të krijojë planin mësimor i cili i përmbush kërkesat private dhe profesionale të tij, dhe pastaj zgjedh trajnimin dhe

materialin mësimor i cili është në dispozicion. Plani mësimor i ECDL-së është unik, duke qenë i tëri i pavarur dhe rregullisht i përditësuar. Tashmë veç standard botëror, Komisioni Evropian rekomandon të gjithë anëtarët të kenë ECDL-në si bazë për akreditim në IT.



► Certifikatat

Çdo provim i marrë shënohet në Skills Card-ën personale; kur kandidati i kalon provimet për shtatë (7) modulet ai pajiset me diplomën e ECDL-së s cila lëshohet nga ECDL Switzerland AG. Ekzistojnë tri grupe të certifikatave për kandidatë

- ECDL Start
- ECDL Core
- ECDL Advanced (për modul ose si e ashtuquajtur bundle të gjitha Modulet Advanced)

Jo gjithmonë paraqitet nevoja për aftësimin në 7 module. Bazuar në kandidati ose nevojat e punëdhënësit kandidati mund të fokusohet edhe në një sferë të veçantë. Në këtë rast ECDL Start Diploma është një zgjedhje ideale e cila lëshohet pasi kandidati të kaloj cilat do katër (4) nga gjithsej shtatë (7) modulet.

Të ecim drejt ECDL Advanced

Nëse kandidati tani më veç ka fituar ECDL Diplomën mund të shkojë para për t'i perfeksionuar aftësitë kompjuterike me ECDL Advanced Diploma. ECDL Advanced është një program i nivelit të lartë i cili çon përpara njohuritë dhe shkathtësitë kompjuterike.



Approved
Test Centre



ETF është një agjenci i BE-së, e cila promovon vlerat dhe objektivat e Bashkimit Evropian. Në veçanti, puna e ETF-it bazohet në kontributin fundamental që arsimimi dhe trajnimi profesional bën në ngritjen e konkurrencës, mundësive të punësimit dhe lëvizshmërisë në ekonomitë moderne. Si qendër e ekspertizës, kontribuojmë në zhvillimin e qëndrueshëm socio-

ekonomik duke iu mundësuar vendeve partnere që të reformojnë sistemin e arsimit dhe trajnimit profesional, kryesisht përmes programeve EC Phare, CARDS, Tacis dhe MEDA. ETF punon në emër të institucioneve të Bashkimit Evropian, posaçërisht në emër të Komisionit Evropian. Momentalisht operon në vendet candidate, në Evropën Juglindore, Evropën Qendrore dhe Azinë Qendrore dhe

regjionin e Mesdheut. Me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve të veta në fushën e reformave të arsimit dhe trajnimit profesional në Kosovë, ETF ka përzgjedhur APPK-në si partner implementues për kryerjen e shërbimeve në vijim.

1. Gjetja dhe angazhimi i ekspertëve lokal për të gjitha çështjet që ndërlidhen me arsimin dhe trajnimin, tregun e punës dhe punësimin në Kosovë. Gjetja dhe angazhimi i ekspertëve lokal për të gjitha çështjet që ndërlidhen me arsimin dhe trajnimin, tregun e punës dhe punësimin në Kosovë

Duke punuar me hartuesit lokalë të politikave, ETF ka nevojë të vazhdueshme për kontribut nga ekspertë lokalë të cilët mund të ekzekutojnë hulumtimet në terren, të hartojnë

artikuj me tematikë të bazuar në situatën lokale, të bëjnë prezantime të fokusuara për punëtorë apo seminare të projekteve, të punojnë në ekip me ekspertët e ETF-it për studimet shtetërore dhe të ofrojnë

informata dhe statistika të freskëta. Ekspertëve lokalë shpesh iu ofrohen detyra afatshkurta dhe duhet të integrohen shpejt në ekipet e projekteve të ETF-it me qëllim të kombinimit të kompetencave

➤ Për të ndihmuar aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve, ndarjen e përvojave nëpër regjionin e Evropës Lindore dhe Juglindore, diskutimin e politikave me vendimmarrësit, etj, ETF nëpërmjet APPK-së rregullisht organizon evente siç janë, sesione trajnuese për grupe synuese, workshope, seminare dhe evente përmblylëse të projektit. Këto kryesisht kanë për qëllim shkëmbimin e ideve dhe informatave në nivel lokal ose të regjionit dhe kryesisht organizohen si takime për punë praktike dhe shpesh janë ngushtë të lidhura apo pjesë e aktiviteteve për të cilat kontraktohen ekspertë. Është përgjegjësi e APPK-së të sigurojë se të gjitha çështjet logjistike janë zgjidhur me kohë për të mundësuar implementimin e lehtë të aktiviteteve dhe kushte ideale të punës.

” Çdo provim i marrë shënohet në Skills Card-ën personale; kur kandidati i kalon provimet për shtatë (7) modulet ai pajiset me diplomën e ECDL-së së cila lëshohet nga ECDL Switzerland AG. Ekzistojnë tri grupe të certifikatave për kandidatë.





- **Goethe-Institut është institucion kulturor I Republikës Federale të Gjermanisë, i cili vepron në mbarë botën.**

Promovon studimin e gjuhës gjermane jashtë Gjermanisë dhe inkurajon shkëmbimin ndërkombëtar të kulturave. Gjithashtu ngritë nivelin e njohurive për Gjermaninë duke ofruar informata mbi kulturën, shoqërinë dhe politikën e gjermane.

- **Aktualisht, aktivitetet e Goethe Institute në Kosovë janë të përfaqësuara nga Goethe Beograd dhe Selanik.**

➤ Që nga tetori 2007 Goethe nga Selaniku është duke implementuar aktivitetet e tij në Kosovë në bashkëpunim/ partneritet me APPK-në, posaçërisht në një segment të veçantë të gjuhës gjermane, që është i ndërlidhur me procesin e quajtur "bashkim familjar" e i cili është shumë aktual në shoqërinë kosovare.

Në bazë të rekomandimeve nga Ambasada Gjermane, ky institut është duke implementuar këto teste në objektin e APPK-së. APPK është gjithashtu përgjegjëse edhe për ofrimin e përkrahjes administrative dhe logjistike në organizimin e përgjithshëm të aktiviteve të këtij instituti.

- **Deri më tani, nëpërmjet këtij procesi janë procesuar mbi 10,000 certifikata të kandidatëve, që përfaqëson numrin më të madh të kandidatëve të certifikuar në regjion..**







Të arriturat e APPK-së në shifra

- ▶ **10 vite të punës së APPK-së dhe bashkëpunimi shumë produktiv në mes të donatorëve, institucioneve kosovare, përfituesve dhe APPK-së, kanë rezultuar në arritjet e mëposhtme:**
- ▶ Mbi 10,800 qytetarë kosovarë janë përkrahur në rrugën e tyre drejt (re)integritit ekonomik, prej të cilëve:
 - ▶ 5500 nëpërmjet ndërmjetësimit në punësimin
 - ▶ 1100, nëpërmjet aftësimeve/trajnimeve profesionale, dhe mbi 80% e tyre të punësuar nëpër kompani të ndryshme pas programeve të aftësimin/trajnimeve të përfunduara
 - ▶ 2200 nëpërmjet themelimit të afarizmit privat (vet-punësim, partneritet), duke krijuar kështu
 - ▶ 1900 biznese të reja, me mbi 4000 vende të reja pune.
- ▶ Mbi 2200 qytetarë kosovarë janë përgatitur në aspektin gjuhësor dhe kulturor, para migrimit të tyre në Gjermani.
- ▶ Mbi 2,000 biznese kosovare kanë përfituar nga punësimi i kuadrit profesional, duke u përkrahur në të njëjtën kohë edhe në aspektin financiar.
- ▶ Janë organizuar mbi 300 evente komplekse vendore dhe ndërkombëtare
- ▶ Mbi 850 të certifikuar në fushën e teknologjisë informative.
- ▶ Nga 2 të punësuar sa kishte në vitin 2000, APPK sot numëron 36 të punësuar të rregullt dhe mbi 100 bashkëpunëtor të jashtëm.
- ▶ Përveç zyrës qendrore në Prishtinë, APPK ka edhe 5 zyre regjionale.
- ▶ Nëpërmjet këtyre projekteve, shoqëria dhe ekonomia kosovare ka përfituar 11 milion Euro përkrahje financiare.


TË ARRITURAT E APPK-SË NË SHIFRA




► Ndërmjetësimi i kuadrit profesional sipas donatorëve



► Përfituesit në bazë të formave të ndryshme të ri-integrimit



► Trajtime dhe aftësimet profesionale në bazë të fushave të ndryshme



► Përfituesit nga seminarët dhe grantet për themelime të afarizmit privat sipas donatorëve



Profilet e pjesëtarëve të stafit

- **Bedri Xhafa** mban pozitën e udhëheqësit të përgjithshëm të APPK-së dhe njëherit është edhe themelues i APPK-së. Detyrat dhe përgjegjësit kryesore të tij janë koordinimi i të gjitha projekteve që implementohen si në aspektin e brendshëm ashtu dhe në raport me donatorët, partnerët dhe përfituesit. Përkujdeset vazhdimisht për azhurnimin e projekteve të reja, zhvillimin e mëtejshëm të organizatës, ndërlidhjen e aktiviteteve të zhvilluara në raport me institucionet vendore dhe ndërkombëtare.
- **Fatmir Rushiti** mban pozitën e menaxherit të projekteve në APPK. Detyrat dhe përgjegjësit kryesore të tij janë koordinimi i projekteve për (re) integrim socio-ekonomike, përgatitje të aplikacioneve për tenderë/ Grante të EU-së, menaxhimi i kontratës afatgjate me ETF -in për koordinimin e aktiviteteve të tyre në Kosovë. Ai njëherit është edhe anëtar i bordit menaxhues të APPK-së. Përvoja e tij gjatë në lëmin e prokurimit dhe fushave të ndryshme të menaxhimit i kontribuon zhvillimit të APPK-së.
- **Vjollca Gërvalla** është menaxhere e trajnimeve në APPK. Ajo është përgjegjëse për organizimin dhe menaxhimin e trajnimeve dhe aftësimeve profesionale bazuar në kërkesat e tregut të punës. Hartimi i kurrikulave të trajnimeve, identifikimi dhe caktimi i trajnerëve, monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i trajnimeve janë gjithashtu përgjegjësi e Vjollcës. Ajo përkujdeset për mbarrëvajtjen e bashkëpunimit me institucione publike, private dhe partner përkatës të ndërlidhur me trajnime dhe aftësime profesionale. Përvoja e saj e mëhershme në lëmin e arsimit, përkushtimi ndaj punës si dhe investimi në zhvillimin e vazhdueshëm profesional, janë faktorë që i kontribuojnë në masë të madhe zhvillimit të trajnimeve dhe aftësimeve profesionale, si pjesë e ofertës së APPK-së.

➤ **Arsim Blaku** është koordinator i ndërmjetësimeve në punësim.

Hulumtimi i tregut të punës dhe këshillimi i punëdhënësve potencialë për fushat e caktuara të zhvillimit të resurseve njerëzore me qëllim implementimin e suksesshëm dhe të qëndrueshëm të ndërmjetësimeve në punësim, përbëjnë përgjegjësitë kryesore të tij. Arsimi ka përvojë mbi dhjetëvjeçare në menaxhimin dhe implementimin e projekteve për gjenerimin e të ardhurave,. Përgatitja profesionale, aftësitë komunikuese, puna ekipore si dhe gatishmëria për të fituar njohuri shtesë e ngrisin efikasitetin, besueshmërinë dhe profesionalizmin në punën e tij.

➤ **Agron Rexhepaj** është koordinator i trajnimeve dhe aftësimeve profesionale.

Përgjegjësitë kryesore të tij kanë të bëjnë me identifikimin e nevojave për trajnime të kandidatëve si dhe organizimin e trajnimeve në bazë të nevojave të tregut të punës me qëllim të ngritjes së aftësive profesionale dhe krijimit të vendit të punës më të qëndrueshëm. Agroni ka përvojë disa vjeçare në bartjen e njohurive teknike si dhe në organizimin e trajnimeve konkrete. Ai vazhdimisht ka qenë pjesëmarrës aktiv në trajnime për ngritje të aftësive menaxhuese dhe organizative. Të gjitha këto të kombinuara me aftësi të shkëlqyeshme komunikimi dhe gatishmëri për punë ekipore, i mundësojnë Agronit që punët e tij t'i kryejë në mënyrë profesionale dhe me efikasitet e besueshmëri të lartë.

➤ **Agron Avdijaj** është i angazhuar si koordinator i themelimit të afarizmit privat. Ai koordinon implementimin e të gjitha trajnimeve për themelim të afarizmit privat në të gjitha fazat e tyre.

Vlerëson planet e bizneseve, vlerëson parakushtet e kandidatëve në terren, përkrah themelimin dhe zhvillimin e bizneseve të themeluara për gjatë gjithë fazës pasuese.

Përveç përvojës në lëmin e lartpërmendur, ai ka punuar edhe si trajner i ndërmarrësisë në projekte të ndryshme të zhvillimit dhe integritit ekonomik në Kosovë.

Njohja e rrethanave sociale dhe ekonomike në Kosovë, aftësia për të krijuar raporte të shkëlqyera ndërpersonale, kreativiteti dhe përshtatshmëria ndaj rrethanave të cilat paraqiten gjatë realizimit të punës kanë kontribuar në realizimin e suksesshëm të detyrave të punës.

- ▶ **Naim Shala** është koordinatori i logjistikës dhe eventeve. Ai është përgjegjës për menaxhimin e logjistikës përfshirë këtu mirëmbajtjen e objektit, furnizimin, mirëmbajtjen e automjeteve, si dhe koordinimin e eventeve në organizatë. Naimi para se të bëhet pjesë e APPK-së, ka qenë pjesëtar i TMK-së. Naimi me profesionalizmin dhe aftësitë e tij organizative dhe ndërpersonale ka kontribuar në ngritjen e nivelit të profesionalizmit të përgjithshëm në APPK.

.....
- ▶ **Besa Miftaraj** është koordinatore e financave. Ajo është përgjegjëse për menaxhimin e departamentit të financave përfshirë këtu: udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e financave dhe stafit në këtë departament si dhe përgatitjen e raporteve për projekte, donatorë dhe autoritete vendore. Përvoja e saj e gjatë në këtë lëmi në kuadër të APPK-së dhe zhvillimi i vazhdueshëm në aspektin profesional e bëjnë atë që t'i kryejë punët e saja në mënyrë profesionale. Ndër aftësitë e veçanta të Besës janë aftësitë menaxheriale dhe organizative, aftësia për punë në grup, vetiniciativa si dhe gatishmëria për punë nën presion.

.....
- ▶ **Esad Luta** është zyrtar për teknologji informative dhe të komunikimit (TIK). Ai është përgjegjës për menaxhimin e sistemit të TIK, përfshirë këtu: mirëmbajtjen dhe funksionimin e pajisjeve harduerike dhe gjithashtu edhe të softuerit dhe bazës së të dhënave të APPK-së. Gjithashtu ai është trajner i licencuar për ECDL. Esadi para se të bëhet pjesë e ekipit të APPK-së, ka punuar në Zyrën e Kryeministrit poashtu si zyrtar për TIK. Të veçantat që Esad-in e bëjnë pjesë të APPK-së përveç anës profesionale janë: Aftësia për punë në grup, vetiniciativa, aftësia për trajnim, gatishmëria për të punuar nën presionin e kohës etj.

.....
- ▶ **Rondinella Hoxha-Gashi** është zyrtare për marrëdhënie me publikun. Ajo është përgjegjëse për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha çështjeve dhe aktiviteteve të ndërlidhura me marrëdhëniet e APPK-së me publikun, përfshirë këtu edhe imazhin e saj. Në përvojën e saj dhjetëvjeçare, Rondinella ka mbajtur pozita të ndryshme menaxheriale dhe pozita të ndërlidhura me informimin publik dhe marrëdhëniet me publikun. Aftësitë e saj menaxheriale, organizative, sociale dhe ndërpersonale, kontribuojnë në ngritjen e vazhdueshme të APPK-së

- **Kumrije Prelvukaj** është kontabiliste në APPK. Detyrat dhe përgjegjësitë e saja në kuadër të pozitës që mban përveç punëve të përditshme të kontabilitetit, janë edhe përkrahja përmbajtësore dhe administrative gjatë raportimeve të ndryshme financiare. Më parë ka punuar në NTJ "Eximkos" si referente e pavarur për shitje të niklit në vend dhe jashtë vendi për 9 vite, pastaj në „Proterm“ si kontabiliste ku ka bërë një përvojë shtatë vjeçare, e cila i ka shërbyer ngritjes profesionale dhe personale të Kumrisë. Shkathtësitë e saja kryesore - profesionalizmi, qasja me seriozitet ndaj punës, besueshmëria, aftësia për punë në grupe si dhe lojaliteti e bëjnë atë një bashkëpunëtoresh shumë të përshtatshme APPK-së.
-
- **Annamaria Farkas-Mecinaj** është bashkëpunëtoresh në Njësinë e kurseve të gjuhës Gjermane dhe docente e gjuhës Gjermane për nivelet gjuhësore A1 - C1. Ajo është Koordinatorë e projektit "Të arrish i përgatitur në Vendin e ri" ("Vorbereitet ankommen in der neuen Heimat") nga Diakonie dhe EIF (Europäische Integration Fond) . Herë pas here ajo është e angazhuar si testuese/vlerësuese për provimet "Start Deutsch 1", të cilat implementohen nga Goethe – Institut-i . Përvoja e fituar nga pjesëmarrja në seminare të shumta për metodologjitë moderne të mësimdhënies, saktësia në punë, puna e mirë ekipore, fleksibiliteti, gatishmëria për avancim të mëtejshëm i kontribuojnë punës së saj të suksesshme.
-
- **Sedat Heroi** është këshilltar për (re)integrim ekonomik në regjionin e Prizrenit. Ai bën këshillimin iniciues, si dhe merr pjesë në orientim dhe profilizim të kandidatit. Në bashkëpunim me koordinatorët hulumton, realizon, përkrah dhe monitoron të gjitha rastet për RE. Si menaxher shumëvjeçar ka mjaft përvojë në këshillim, trajnime profesionale dhe në punësim, kurse si ndërmarrës në themelimin dhe ngritjen të afarizmit privat. Shkathtësitë e fituara në organizim të prodhimit, administrim biznesi dhe menaxhim kanë ndikuar direkt në krijimin e raporteve të mira me kandidat duke i mbështetur me profesionalizëm të gjitha aktivitetet e parapara të Programit.

- ▶ **Ardian Imeti** është këshilltar për (re)integrim ekonomik në regjionin e Prishtinës.

Ai këshillon kandidatin për të gjitha format e RE. Në bashkëpunim me koordinatorët realizon, përkrah dhe monitoron të gjitha rastet përmes formave të RE. si dhe bashkërendon punët ditore për regjionin e Prishtinës. Ardiani ka përvojë mbi dhjetëvjeçare në projekte me organizata ndërkombëtare. Në lëminë e integritit ekonomik, ai është ka qenë i involvuar në projekte për gjenerim të të ardhurave.

Përgatitja profesionale, aftësitë komunikuese si dhe lojaliteti ndaj programit e ngrisin efikasitetin, besueshmërinë dhe profesionalizmin në punën e tij gjë që ka reflektuar ne punën e tij gjerë më tani.

.....
- ▶ **Valdet Jakupi** është këshilltar i (re)integritit ekonomik për regjionin e Pejës. Përgjegjësitë e tij mes tjerash përfshijnë këshillimet individuale te kandidatëve në regjionin e Pejës, organizimin e takimeve dhe seminareve për kandidatë, identifikimin e mundësive të punësimit në sektorin publiko-privat si dhe monitorimin e mbarëvajtjes së punës.

Përvojën e tij në fushën e ri-integritit ekonomik e fitoi gjatë punës 9 - vjeçare në organizatën joqeveritare humanitare ICMC, organizatë kjo e cila ishte partneri kryesor i UNHCR-së.

Angazhimi serioz në punë, gatishmëria për bashkëpunim, mirësjellja dhe aftësitë e shkëlqyeshme komunikuese e bëjnë Valdetin shumë të përshtatshëm për pozitën që mbanë në APPK.

.....
- ▶ **Shkëlzen Hasani** mban pozitën e këshilltarit për (re)integrim ekonomik në regjionin e Gjilanit..

Ai është përgjegjës për këshillimin e kandidatëve për të gjitha format e (re)integritit ekonomik.

Në bashkëpunim me koordinatorët e ndërmjetësimit në punësim, të trajnimeve profesionale dhe themelimit të afarizmit privat, ai përkrah dhe monitoron të gjitha rastet. Shkëlzeni ka përvojë shumëvjeçare në (re)integrimin ekonomik të të zhvendosurve nga Kosova, përmes projekteve të implementuara përmes NRC, UMCOR, UNDP, IOM, UNHCR. Shkathtësitë e shkëlqyeshme ndër-personale, organizative, gatishmëria për punë ekipore dhe njohuritë teknologjike dhe njohja e gjuhëve të huaja si Angleze e Serbo-Kroate kontribuojnë ne te mirën e mbarëvajtjes së punës në APPK.

► **Naim Gjafa** është këshilltar për (re)integrim ekonomik në regjionin e Mitrovicës.

Ai këshillon kandidatët për të gjitha format e (re)integrim ekonomik. Realizon hulumtime të vazhdueshme të mundësive për RE. Në bashkëpunim me koordinatorët e RE realizon, përkrah dhe monitoron të gjitha rastet, përmes të gjitha formave të RE. Nga eksperiencia e tij e mëhershme, ka përvojë të gjatë dhe performancë të shkëlqyeshme në këshillimin e klientit. Ai organizon koordinimin e kohës, kryerjen e detyrave me përgjegjësi dhe besueshmëri, bën punën nën presion të kohës, ka qasje të mirë me klientët.

► **Faruk Hoti** është këshilltar i (re)integritit ekonomik në regjionin e Skenderajt.

Këshillimi i kandidatëve rreth programit për ri-sistemim të pjesëtarëve të ish-TMK-së dhe zbatimi i programit, vizitat në terren me qëllim të vlerësimit dhe monitorimit të mbarëvajtjes së projektit, hulumtimi për vende të punës, janë vetëm disa nga përgjegjësitë e Farukut si këshilltar për (re)integrim ekonomik. Falë aftësive të tij komunikuese, menaxhuese, organizative dhe qasjes së mirë ndaj secilit individ, Faruku është një pjesëtar i vlefshëm i stafit të APPK-së.

► **Fatmir Qerimi** është i angazhuar në pozitën asistent i trajnimeve në APPK. Në punët e tij të përditshme këshillon kandidatët e interesuar për kurse të gjuhës gjermane si dhe udhëheqë administratën e këtyre kurseve, administratën e provimeve të Goethe Institut si dhe të projektit Diakonie. Fatmiri gjithashtu për këto projekte zhvilloi bazat e të dhënave përkatëse të cilat tash i mirëmban dhe zhvillon. Gjithashtu ai është trajner i licencuar për ECDL. Më parë ishte bashkëpronar në kompaninë Myndwork studio në të cilën ka udhëhequr departamentin e IT-së dhe administratës. Posedimi i aftësive të mira komunikative si dhe atyre të IT-së i kontribuojnë që t'i kryejë punët në mënyrë shumë profesionale.

► **Ganimete Gogiqi** është asistente e organizatës. Ajo realizon secilin kontakt të parë me klientin, bashkëpunon me partnerë dhe institucione në aspektin e krijimit të kontakteve dhe korrespondencave përkatëse, varësisht prej kërkesave të bashkëpunëtorëve. Varësisht nga aktivitetet e projekteve, kryen edhe obligime tjera në kontekst të zhvillimit të organizatës.

Ajo ka eksperiencë të mëhershme në organizimin e punëve administrative dhe kontaktit me klientët. Shkathësitë më të rëndësishme të Ganimetes, të cilat i kontribuojnë mbarëvajtjes së punëve në APPK janë ato që kanë bërë me organizimin e kohës, menaxhimin e stresit, vendosjen e prioriteteve dhe qasjen e mirë ndaj klientit.

▶ **Adelina Jusufi-Dalipi** mban pozitën e asistentes së projekteve. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të saj janë administrimi përkatës i dokumentacionit të projekteve, në veçanti i raporteve të ndryshme, si dhe koordinimi kohor dhe administrativ i të gjitha aktiviteteve të ndërlidhura me koordinatorin e projektit përkatës. Adelina posedon përvojë në fusha të ndryshme të cilat ndërlidhen me pozitën e tanishme. Aftësitë e shkëlqyeshme komunikuese, përkushtimi dhe përgjegjshmëria e saj ndaj punës e bëjnë kontributin e Adelinës shumë të vlefshëm për APPK-në.

▶ **Zejxhane Sogojeva** është asistente e projektit të Goethe Institutit. Ajo këshillon kandidatët të cilët synojnë bashkimin familjar në Gjermani për mënyrën e paraqitjes së provimit “Start Deutsche 1”. Varësisht nga aktivitetet e projektit, kryen edhe obligime tjera dhe njëkohësisht këshillon dhe regjistron kandidatet për kurse intensive me 168 ore mësimi dhe për kurse 2 javore. Ajo ka eksperience të mëhershme në fushën e shërbimit ndaj klientit. Qasja profesionale ndaj klientëve e bën Zejxhanen person shumë të përshtatshëm për pozitën që mban në APPK.

▶ **Luljeta Istrefi** është asistente e këshilltarit për (re)integrim ekonomik në regjionin e Prishtinës. Përgjegjësi e saj është informimi i kandidatëve për të gjitha format e ri-integrimit ekonomik. Ajo poashtu i ofron përkrahje këshilltarit në të gjitha aktivitetet operative dhe administrative, gjatë implementimit të projekteve për (re)integrim ekonomik. Luljeta ka një përvojë të gjatë në këshillimin e klientëve dhe punët e ndryshme administrative. Falë aftësive për menaxhim të kohës, kryerje të detyrave nën presion të kohës dhe përgjegjësi ndaj punës, Luljeta i kontribuon performacës së shkëlqyeshme të APPK-së.

▶ **Agron Hajdari** është asistenti i këshilltarit për (re)integrim ekonomik në regjionin e Skenderajt. Përgjegjësitë e tij përfshijnë asistimin e këshilltarit në kryerjen e detyrave, këshillimi/informimin e kandidatëve dhe kryerjen e punëve administrative në zyrë, Agroni ka një përvojë të madhe me të punës në OJQ, në cilësinë e trajnerit dhe menaxherit të projekteve. Përvoja e tij e plotësuar edhe nga aftësi të shkëlqyeshme komunikuese, organizative dhe menaxhuese si dhe profesionalizmi e stabiliteti i tij në punë, përbëjnë një kontribut të vlefshëm për ngritjen e cilësisë së punës në APPK.

- **Fëllanza Ismajli-Morina** është asistente e këshilltarit për (re)integrim ekonomik në regjionin e Gjilanit. Informimi i kandidatëve për të gjitha format e RE, inkorporimi i shënimeve në bazën e të dhënave, mirëmbajtja e shënimeve administrative dhe përkrahja e këshilltarit për RE janë përgjegjësitë kryesore të Fëllanzës. Përvoja e saj e mëhershme në fushën e integritimit në shoqëri të grave të prekura nga fenomenet e dhunimit, trafikimit dhe të dhunës në familje, e kombinuar me aftësi të shkëlqyeshme komunikimi, të menaxhimit të punës dhe kohës, të vendosjes së prioriteteve, planifikimit dhe organizimit të punës, e bëjnë kontributin e Fëllanzës shumë të vlefshëm për APPK-në.
-
- **Flaka Bamja** është asistente e këshilltarit për (re)integrim ekonomik në regjionin e Prizrenit. Flaka është përgjegjëse për informimin e kandidatëve për të gjitha format e (re)integritimit ekonomik, regjistrimin fillestar të kandidatëve dhe bartjen e shënimeve në bazën e të dhënave, përkrahjen e këshilltarit në të gjitha aktivitetet që zhvillohen në kuadër të zyrës regjionale si dhe administron me zyrën në përgjithësi. Shkathtësitë e fituara në përvojën e më hershme si asistente administrative, kanë bërë që puna e Flakës të jetë tejet kualitative dhe profesionale.
-
- **Leonora Gjuka-Xharavina** është asistente e këshilltarit të (re)integritimit ekonomik në regjionin e Pejës. Ajo është përgjegjëse për prezantimin fillestar të programit dhe përfitimeve që i ofrohen secilit individ të përfshirë në program, për regjistrimin e klientëve dhe kompletimi i dosjeve të tyre fizike dhe elektronike, si dhe për të gjitha punët administrative rreth menaxhimit të zyrës regjionale. Leonora ka një përvojë të gjatë në shërbimin ndaj klientëve dhe menaxhimin & administrimin e zyrës. Integriteti, profesionalizmi, respekti për diversitetin gjinor, etnik e kulturor dhe aftësitë e mira komunikuese e bëjnë atë pjesë të pandashme e të vlefshme të stafit të APPK-së.
-
- **Vlora Pllana** është asistente e këshilltarit për (re)integrim ekonomik në regjionin e Mitrovicës. Një ndër detyrat më të rëndësishme të asistentes së këshilltarit për regjionin e Mitrovicës është edhe këshillimi inicues si dhe regjistrimi i kandidatëve në program, përfshirë këtu edhe regjistrimin e tyre në bazën e të dhënave. Detyrë tjetër e saj është edhe informimi i kandidatëve lidhur me çdo aktivitet që zhvillohet për ta. Vlora është e diplomuar në Fakultetin Ekonomik dhe falë shkathtësive të saj arrin që çdo obligim ta përmbush me sukses si dhe në afatin e caktuar. Ka njohuri të shkëlqyeshme teknologjike dhe aftësi për planifikim të punës gjë që ndikon në nivel të lartë efikasiteti në punën e saj.

- ▶ **Xhavit Mehmeti** në APPK është i angazhuar në pozitën e asistentit të logjistikës. Në punët e tij të përditshme siguron materialet e nevojshme për zyrën qendrore dhe ato regjionale, përgatit sallat në bazë të kërkesës së klientëve për evente të ndryshme si dhe përkujdeset për gjendjen teknike të automjeteve. Përvoja e tij e mëparshme në logjistikë bën që ai t'i kryej punët e tij me një efikasitet të lartë.

.....
- ▶ **Metush Sahiti** është kuzhinier në kuzhinën interne të APPK-së. Përgjegjësi e Metushit është përgatitja e ushqimit për nevoja të stafit të APPK-së si dhe për evente të organizuara nga APPK-ja. Përvoja e gjatë e tij në fushën e gastronomisë, bën që ushqimet e përgatitura nga kuzhina e APPK-së të krijojnë imazh të mirë për organizatën.

.....
- ▶ **Gilije Kosumi** është asistente e eventeve në APPK. Ajo është përgjegjëse për përkrahjen e aktiviteteve të ndërlidhura me organizimin e eventeve që nga rregullimi i sallave e deri tek aranzhimi i koktejeve të ndryshme. Gilija me efikasitetin, kujdesin për detajet dhe aftësitë organizative i kontribuon atmosferës së mirë në APPK, qoftë për të punësuarit aty dhe për palët e jashtme.

.....
- ▶ **Sadije Dërguti** është asistente e eventeve në APPK. Ajo është përgjegjëse për përkrahjen e aktiviteteve të ndërlidhura me organizimin e eventeve që nga rregullimi i sallave e deri tek aranzhimi i koktejeve të ndryshme. Me sensin e saj për detaje dhe përkushtim maksimal ndaj punës, ajo i kontribuon në masë të madhe organizimit dhe menaxhimit të suksesshëm të eventeve brenda APPK-së.

.....
- ▶ **Halide Ajvazi** është asistente e eventeve në APPK. Ajo është përgjegjëse për përkrahjen e aktiviteteve të ndërlidhura me organizimin e eventeve që nga rregullimi i sallave e deri tek aranzhimi i koktejeve të ndryshme. Halidja është e gatshme të punoj në presion të kohës dhe jashtë orarit të punës.



